



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.07, datë 09.11.2022

**PËR**  
**KONFISKIMIN PËR INTERES PUBLIK TË OBJEKTIT**  
**“GODINË BANIMI DHE SHËRBIMI, 2, 4 DHE 6 KAT, ME 2-5 KAT PARKIM DHE**  
**SHËRBIME NËNTOKË”, ME VENDNDODHJE PRANË LIQENIT TË THATË**  
**(KOPSHTIT ZOOLOGJIK), SELITË, BASHKIA TIRANË,**  
**TË NDËRTUAR NË TEJKALIM TË LEJES SË NDËRTIMIT**

Në mbështetje të nënndarjes “iii” dhe “iv”, të shkronjës “e”, të pikës 1, të nenit 52 të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 589, datë 7.9.2022 “Për rregullat dhe procedurat për konfiskimin për interes publik të objekteve të ndërtuara pa leje, për qëllim fitimi”, me propozim të Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT), pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Konfiskimin për interes publik të objektit të miratuar me vendimin e Kryetarit të Bashkisë Tiranë Nr.X-134444/6, datë 27.11.2020 “Për miratimin e lejes së ndërtimit për objektin “Godinë banimi dhe shërbimi, 2, 4 dhe 6 kat, me 2-5 kat parkim dhe shërbime nëntokë”, me vendndodhje pranë Liqenit të Thatë (Kopshtit Zoologjik), Selitë, Bashkia Tiranë, me zhvillues shoqërinë “Salillari” sh.p.k, i cili është ndërtuar në tejkalim të lejes së ndërtimit, në masën mbi 10 % të sipërfaqes ndërtimit mbi tokë.
2. Planvendosja e objektit të konfiskuar, bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Agjencia e Zhvillimit të Territorit të përcjellë këtë vendim pranë Ministrisë përgjegjëse në varësi të të cilës gjendet autoriteti përgjegjës për administrimin e pasurive të konfiskuara të shtetit.
4. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ose autoriteti përfitues i konfiskimit të aplikojë nëpërmjet sistemit e-leje, për miratimin e një Leje Zhvillimi/Ndërtimi të re, si dhe lëshimin e Çertifikatës së Përdorimit, me qëllim rregullimin e pasojave të shkaktuara nga situata faktike, e krijuar nga ndërtimi në tejkalim të lejes së ndërtimit.



5. Pas miratimit të lejes përkatëse, Bashkia Tiranë të lëshojë certifikatën e përdorimit, në përputhje me këtë vendim dhe planvendosjen bashkëlidhur.
6. Agjencia Shtetërore e Kadastrës të kryejë regjistrimin e këtij vendimi, së bashku me certifikatën e përdorimit, sipas parashikimeve në VKM-në Nr. 589, datë 7.9.2022 “Për rregullat dhe procedurat për konfiskimin për interes publik të objekteve të ndërtuara pa leje, për qëllim fitimi”.
7. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë, Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, Ministrinë e Brendshme dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, për zbatimin e këtij vendimi.
8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**EDD RAMA**



**MINISTËR I BRENDSHËM**

**BLEDAR ÇUÇI**



**ANËTAR**

**MINISTËR I FINANCËVE DHE EKONOMISË**

**DEJINA IBRAHIMAJ**



**ANËTAR / SEKRETAR I KKT**

**DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT**

**LEDIA TOTA**

